

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, si kontestimore e
 nënbërë nga gjyqtari individual **Faton Ademi**, me procesmbajtësen Elheme
 Peci në rështjen juridike të paditëses:
 tani Dukagjini të cilën e përfaqëson sipas autorizimit me shkrim
 kundër të paditurit: nga fshati e Mitrovicës,
 baza e kontestit: Rimbursim dëmi, pas mbajtjes së seancës kryesore me datë:
 19.03.2018 bie këtë:

AKT GJYKIM

- **OBLIGOHET**, i padituri që paditëses t'ia kompensojë shumën prej 129 euro, në emër të rimbursimit/regresit të dëmit material të shkaktuar të dëmtuarit në aksidentin e datës: 17.08.2012, me kamat ligjore si për mjetet e afatizuara në bankë pa destinim të caktuar të gjitha këto në afat 7 ditor nga data e pranimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm
- **OBLIGOHET**, i padituri që paditëses në emër të shpenzimeve procedurale t'ia paguajë shumën prej 15 euro në emër të taksës për padi, ndërsa gjykatës t'ia paguajë taksën për përpilimin e aktgjykimit në shumë prej 15 euro të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga data e pranimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm

Arsyetim

Paditësi me datë: 27.08.2015 ka parashtruar në gjykatë padi për rimbursimin e dëmit, që rrjedh nga aksidenti i datës: 17.08.2012, kundër të paditurit.

Gjykata ka caktuar seancën kryesore me datën: 23.01.2018 në të cilën prezantoi përfaqësuesi i paditëses, ndërsa mungoi i padituri, i cili ishte ftuar me rregull dhe mungesën nuk e kishte arsyetuar.

Përfaqësuesi i paditëses në seancë dhe në fjalën përfundimtare deklaroi: i propozon gjykatës që meqenëse në bazë të provave të administruara është vërtetuar plotësisht baza juridike dhe lartësia e padisë, të njëjtën ta aprovon në tërësi si të bazuara dhe ta obligoj të paditurin që t'ia kthej paditëses shumën prej 129 euro dhe taksën për padi.

Për të vërtetuar gjendjen faktike gjykata administroi këto prova: raporti i aksidentit i dt.17.08.2012, ftesa e datës 14.04.2014, regjistri I pranimit të dërgesave postare, transferi bankar të muajit shtator, kërkesa për kompensim I dt.24.12.2012.

Gjykata provat e administruara i vlerësoi një nga një dhe në raport me provat tjera, konform nenit 7 dhe 8 të LPK-së, ku nga provat e administruara vërtetoi këto fakte:

Për gjykatë nuk është kontestues fakti se i padituri në aksidentin e datës: 17.08.2012 ka qenë pjesmarrës në komunikacion pra ka drejtuar automjetin Opel Omega me targa kjo vërtetohet në bazë të raportit të aksidentit.

Nuk është kontestues fakti se ditën kritike ditën kur ka ndodhë aksidenti i padituri ka drejtuar automjetin pa patent shoferë, kjo konstatohet në raportin e aksidentit në pjesën ku shkruhet tek rubrika e patent shoferit.

Në aksidentin në fjalë janë ndeshur automjeti i të paditurit dhe automjeti i personit të tretë, si pasojë e ndërmarrjes së veprimit nga ana e të paditurit i cili veprim ka qenë I pasigurt pasi ka vozitur në kahjen e kundërt në kundërshtim me rregullat e komunikacionit me q'rast e godet veturën e personit të tretë.

Nuk është kontestues fakti se personi i tretë pjesmarrës dhe i dëmtuar në aksident ka parashtruar kërkesë për kompensim nga paditësja kjo vërtetohet nga kërkesa e datës: 24.08.2012.

Nga transferi bankar vërtetohet se personit të tretë i janë transferuar shuma e mjeteve në lartësi të kërkesëpadisë pra 129 euro në emër të kompensimit të dëmit të shkaktuar nga i siguruari i paditësës.

Nuk është kontestues fakti se paditësja i ka bërë ftesë para padisë të paditurit që të lajmërohet për pagesën në emër të regresit, në të kundërtën do të parashtronte padi, mirëpo nuk ka prova se i njëjti është paraqitur.

Meqenëse i padituri ka drejtuar automjetin pa patent shoferë pra pa leje të vozitjes i njëjti sipas nenit 14 paragraf 1 i Ligjit Mbi Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia ka humbur mbulesën e sigurimit, sipas pasojë e humbjes së mbulesës së sigurimit, pra dëmi i shkaktuar nga i njëjti duhet të regresohet nga ana e paditësës si siguruese meqenëse e njëjta e ka kompensuar personin e tretë.

Në raport me lartësinë e dëmit gjykata në mungesë të provave tjera ia fali besimin vlerësimit të paditësës resektivisht ekspertëve cenzorë të saj edhe pse në një raport i vlerësimit mungon në sakresat e lëndës, por dihet praktikisht se secilin dëmë së pari vlerësohet nga departamenti i dëmit, në kuadër të të cilit punojnë ekspertët në rastin konkret eksperti i makinerisë.

Baza juridike e kërkesëpadisë është në përputhje me dispozitën ligjore nenin 14 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia dhe nenin 948 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD i vjetri).

Arsyeja e aplikimit të ligjit të vjetër konsiston në faktin se baza juridike është krijuar në kohën kur në fuqi ka qenë Ligji i vjetër.

Duke marrë për bazë këtë fakt dhe të cekurat më lartë, gjykata onsideron se padia dhe kërkesëpadia e paditësës është e bazuar.

Gjykata, lidhur me caktimin e kamatës vjetore, u bazua në nenin 277, par.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve të aplikueshëm në rastin konkret,

ndërsa, lidhur me lartësinë e saj, u bazua në lartësinë e mjeteve të deponuara në bankat afariste për një vit pa destinim të caktuar.

Sa i përket shpenzime procedurale gjykata u bazua në nenin 452 paragrafi i të LPK-së, ku pala e cila e ka humb kontestin duhet t'ia paguajë palës tjetër shpenzimet procedurale.

Aktgjykimi u mor konform nenit 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
C.Nr.479/2015 datë: 19.03.2018

GJYQTARI
Faton Ademi



UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtën e ankesës në afat prej 7 ditor, nga dita e pranimit së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë – nëpërmjet kësaj Gjykate.

exp: P/leve
19.3.2018
[Signature]